



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 119 Prot.

Tiranë, më 18 / 01 / 2021

V E N D I M

Nr. 7, Datë 18 / 01 / 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 165, datë 30.12.2020, të A. M kundër Bashkisë Kurbin dhe Kryeministrit, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se është në gjendje të vështirë ekonomike dhe shëndetësore pasi të ardhurat e vetme financiare sigurohen nga pagesa e paaftësisë së tij në masën 13370 lekë dhe shtesa mujore mbi pensionin e invaliditetit në masën 3300 lekë. Ankuesi shprehet se ka tre fëmijë minorenë dhe se ka kryer dy ndërhyrje kirurgjikale në zemër.

Në vijim të ankesës së tij ai citon se: *“Nga 2013 kam kaluar shumë probleme. Kam qenë dy herë në burg: 16 muaj në Maqedoni dhe 23 muaj në Greqi. Kam njëqind halle dhe i jam drejtuar disa herë për ndihmë kryetares së Bashkisë për të më siguruar një vend pune si sanitare për gruan dhe më është përgjigjur negativisht se “Nuk kam çfarë të bëj!”. Gjatë 7-8 muajve i jam drejtuar 4 herë me letër Kryeministrit të Shqipërisë z. Edi Rama dhe nuk kam marrë asnjë përgjigje”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri që problematika e tij të merret në konsideratë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, konstatohet se:

- *Së pari*, ankuesi nuk ka paraqitur prova apo dokumentacion shkresor mbi bazën e të cilit të provohet fakti që bashkëshortja e tij ka depozituar kërkesë me shkrim pranë Institucionit lidhur me kërkesën e saj për punësim.

- Së dyti, lidhur me pretendimin që ankuesi ka kundër Bashkisë Kurbin për mos marrjen në konsideratë të kërkesës së tij për punësimin e bashkëshortes në pozicionin e sanitares, Komisioneri vëren se, ai nuk legjitimohet si subjekt që mund të paraqesë ankesë në emër të bashkëshortes së tij, pasi duhet të ketë marrë paraprakisht pëlqimin me shkrim prej saj për përfaqësimin para KMD-së ose ankesa mund të paraqitet nga vetë bashkëshortja e A. M;
- Së treti, lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim nga ana e Kryeministrit, nuk është sjellë asnjë provë shpresore dhe nuk evidentohet se çfarë ka pretenduar dhe për çfarë është ankuar konkretisht. Mbetet i pasqaruar objekti i kërkesës së ankuesit ndaj Kryeministrit si dhe nuk ka informacion të mjaftueshëm lidhur me pretendimin e tij për diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike dhe aftësisë së kufizuar apo lidhur me masat konkrete që ka kërkuar të ndërmerren për rregullimin e situatës së tij financiare.

Bazuar në deklaratimet e depozituara nga ankuesi, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezultojnë se ai nuk ka depozituar dokumentacionin e nevojshëm për të dokumentuar pretendimet e tij.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në përfundim, Komisioneri i sugjeron ankuesit, lidhur me pretendimin për punësimin e bashkëshortes së tij pranë Bashkisë Kurbin, që fillimisht ajo të depozitojë një kërkesë me shkrim pranë këtij Institucioni konform kërkesave ligjore për punësimin e punonjësve në institucionet publike.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit A. M, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Gjendja ekonomike, AK
Lloji i vendimit: Mospranim